


	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	Operatorin Ekonomik: N.T.P. "LULISHTJA BUÇAJ" me adresë në Graçanicë Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	11.02.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për ri-shqyrtim** të datës: 10.02.2020, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: N.T.P. "LULISHTJA BUÇAJ" me adresë në Graçanicë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **KRIJIMI I HAPËSIRAVE GJELBERUESE DHE MBJELLJA E DRUNJËVE DEKORATIV**, Numri i Prokurimit: 623-19-6024-5-2-1, Nr. i brendshëm: 623-19-052-5-2-1, **KRIJIMI I HAPËSIRAVE GJELBERUESE DHE MBJELLJA E DRUNJËVE DEKORATIV – Loto I**, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: N.T.P. "LULISHTJA BUÇAJ" me adresë në Graçanicë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **KRIJIMI I HAPËSIRAVE GJELBERUESE DHE MBJELLJA E DRUNJËVE DEKORATIV**, Numri i Prokurimit: 623-19-6024-5-2-1, Nr. i brendshëm: 623-19-052-5-2-1, **KRIJIMI I HAPËSIRAVE GJELBERUESE DHE MBJELLJA E DRUNJËVE DEKORATIV – Loto I**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: 06.02.2020, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autorteti Kontraktues vendos të vazhdoj Vendimin e miratuar nga Autoriteti Kontraktues për aktivitetin e prokurimit: **KRIJIMI I HAPËSIRAVE GJELBERUESE DHE MBJELLJA E DRUNJËVE DEKORATIV**, Numri i Prokurimit: 623-19-6024-5-2-1, Nr. i brendshëm: 623-19-052-5-2-1, **KRIJIMI I HAPËSIRAVE GJELBERUESE DHE MBJELLJA E DRUNJËVE DEKORATIV – Loto I**, dhe mbështetë Vendimin e miratuar nga Autoriteti Kontraktues.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik: N.T.P. "LULISHTJA BUÇAJ" me adresë në Graçanicë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **KRIJIMI I HAPËSIRAVE GJELBERUESE DHE MBJELLJA E DRUNJËVE DEKORATIV**, Numri i Prokurimit: 623-19-6024-5-2-1, Nr. i brendshëm: 623-19-052-5-2-1, **KRIJIMI I HAPËSIRAVE GJELBERUESE DHE MBJELLJA E DRUNJËVE DEKORATIV – Loto I**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: 06.02.2020, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: 10.02.2020, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

Baza Ligjore për refuzim të kërkesës

Autoriteti Kontraktues hedh poshtë pretendimin e OE dhe njëherit konfirmon se AK Komuna e Rahovecit ka vlerësuar ofertat në përputhje me LPP-në.

Komisioni i Ri-vlerësimit ka vlerësuar, ekzaminuar dhe krahasuar, ofertat e operatorëve ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit dhe ka respektuar nenin 7 par. 1 të LPP-së, po citoj: *Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.*

Duke u bazuar në fakte dhe duke pas parasysh analizën se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në këtë pikë **nuk është i qëndrueshme.**

Komisioni Ri-vlerësues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pas në dispozicion, vjen në përfundim se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave është bërë konform nenit 59 të LPP-së, pasi të gjithë OE janë të papërgjegjshëm, dhe ka rekomanduar Zyrën e Prokurimit për Anullim të procedurës pasi që asnjë OE nuk i ka plotësuar kërkesat e AK-së të publikuara në njoftim për kontratë dhe dosje të tenderit dhe njëkohësisht e ka obliguar autoritetin kontraktues që të respektoj në përpikëri të gjitha dispozitat e LPP-së dhe kërkesat e veta të vendosura në njoftimin për kontratë dhe doje të tenderit.

Ju si OE ankues me datë: 06.02.2020, jeni njoftuar duke ia cekur arsyetim se tenderi juaj është refuzuar për këto arsye, *referohu formularit: B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar.*

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Kundër këtij vendimi të AK-së ju munde të paraqitni ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Komuna e Rahovecit

